



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 54 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe të Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 27.09.2021, merr këtë:

#### VENDIM

##### për akreditim të grupit të vëzhguesve të Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, për akreditimin e grupit të Vëzhguesve të partisë politike **"Lidhja Demokratike e Kosovës"** me katërmijënjëqindpesëdhjetekatër (4154) vëzhgues afatgjatë, për vëzhgimin e aktiviteteve zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më 17 tetor 2021.
- II. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar ta njoftojë partinë politike **"Lidhja Demokratike e Kosovës"** me obligimet e organizatave të akredituara dhe vëzhguesve të tyre që rrjedhin nga neni 4 i Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve.
- III. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar ta njoftoj partinë politike **"Lidhja Demokratike e Kosovës"** për marrjen e këtij vendimi.
- IV. Lista e vëzhguesve të partisë politike **"Lidhja Demokratike e Kosovës"** është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



**Këshillë juridike:** Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP.